

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. A. nga fshati S., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.58/2017, të datës 28.02.2017, e cila është përmirësuar me datën 14.05.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 20.07.2018, në prezencën e Prokurorit të shtetit Enis Gashi si dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M**I akuzuari:**

A.A., nga i ati M., e ëma Gj., e gjinisë G., data e lindjes ..., në fshatin R., Komuna e Gjakovës, ku edhe tani banon, i martuar, baba i 4 fëmijëve, ka të kryer tri vite të shkollës fillore, bujk i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal:....

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse në mes të datës së pa vërtetuar e gjerë me datën 29.06.2017 në fshatin R., Komuna e Gjakovës, në shtëpinë e tij me qëllim që vetit apo tjetrit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshme me qëllim vjedhje, jashtë njësorit elektrik me numër ..., përmes kabllos është lidhur direkt në shtyllë-rrjetin elektrik, ku energjia elektrike nuk është regjistruar kështu që ka pamundësuar regjistrimin e saktë të energjisë elektrike të shpenzuar e të dëmtuarës K.-Distrikti në Gjakovë, i ka shkaktuar dëme rreth 786.93 Euro, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të K.-Distrikti në Gjakovë.

Me këto veprime ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 41, 42, 46, 49, 50, 51, 52, 73, 74 dhe nenit 320 të KPRK-së të akuzuarit ia shqipton:

D Ë N I M I N M E K U S H T

Duke ia shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) Euro dhe duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

E dëmtuara K.-Distrikti në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juriko-civil.

Detyrohet i akuzuari, që ti paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumën prej 30 (tridhjetë) Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 (tridhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Ar sy e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP.nr.1691/2017 të datës 08.12.2017, kundër të akuzuarit A. Sh. nga fshati R., Komuna e Gjakovës, ku fillimisht të akuzuarin e kishte akuzuar për shkak të veprës penale nga neni 61 par.1 nënpar.1.2 të Ligjit për Energjinë Elektrike të Republikës së Kosovës nr.05/L-85. Prokuroria Themelore në Gjakovë, përmes parashtresës së datës 14.05.2018, ka bërë përmirësimin e aktakuzës duke e bërë rikualifikimin e veprës penale nga neni 61 par.1 nënpar.1.2 të Ligjit për Energjinë Elektrike të Republikës së Kosovës nr.05/L-85 në veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së. Prokurori i shtetit Enis Gashi, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit A. Sh., andaj ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligji.

I akuzuari A. Sh., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe ka shtuar se jam penduar për këtë veprim dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të këtilla.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari A. Sh., në mes të datës së pa vërtetuar e gjerë me datën 29.06.2017 në fshatin R., Komuna e Gjakovës, në shtëpinë e tij me qëllim që vetit apo tjetrit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshme me qëllim vjedhje, jashtë njësorit elektrik me numër ..., përmes kabllor është lidhur direkt në shtyllë-rrjetin elektrik, ku energjia elektrike nuk është regjistruar kështu që ka pamundësuar regjistrimin e saktë të energjisë elektrike të shpenzuar e të dëmtuarës K.-Distrikti në Gjakovë, i ka shkaktuar dëme rreth 786.93 Euro, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të K.-Distrikti në Gjakovë.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së për hedhjen e aktakuzës përkatësisht pushimin e procedurës penale.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprave penale vjedhje e pyllit nga neni 320 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se: është baba i 4(katër) fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, është mbajtës i familjes 7 (shtatë) anëtarësh, të ardhurat i siguron kryesisht me punën e tij në bujqësi, nuk ka të ardhura të rregullta, në gjykim ka patuar qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të akuzuarin gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe këto dënime

si të tillë të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në parandalimin e të akzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjnë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko- civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.2 lidhur me par.1 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitivin të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.848/17, me datë 20.07.2018

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.